

Reflektim pas mbledhjes së parë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore

KOHA PËR DEMOKRACI TË QENDRUESHME

Tiranë, 15.03.2016. Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e për Demokraci të Qendrueshme (KZLN) po vijon të monitorojë në mënyrë aktive zhvillimet më të fundit për nisjen e reformës zgjedhore në Shqipëri.

Megjithëse nuk mori një ftesë të dëgjojë, KZLN mirëpriti mbledhjen e parë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore dhe nisjen e punës për një reformë gjithpërfshirëse. Parimi i gjithpërfshirjes është theksuar vazhdimisht nga aktorët vendas të shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, të cilët presin angazhimin e anëtarëve të Komisionit dhe partive politike për respektimin e tij gjatë procesit të reformës elektorale.

KZLN kërkon që Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore të angazhohet sa më shpejt në procese konsultimi me shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë të interesuar në mbarëvajtjen e procesit si dhe të marrë në konsideratë rekomandimet e tyre për ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor. Afati i shkurtër tre mujor për përfundimin e punimeve të Komisionit dhe për draftimin e reformës zgjedhore shtron nevojën e organizimit të këtyre seancave sa më shpejt.

KZLN fton Komisionin të marrë në konsideratë faktin që një reformë gjithpërfshirëse konsideron aktorë në proces të gjitha palët e interesuara për mbarëvajtjen e zgjedhjeve në Shqipëri dhe jo vetëm konsensusin e ngushtë midis partive politike, në mënyrë që procesi të jetë gjithpërfshirës jo vetëm në letër, por edhe në produktin përfundimtar që do të paraqitet në Kuvend për miratim. KZLN e konsideron domosdoshmëri demokratike konsultimin e gjerë me aktorë të shoqërisë civile, partnerët ndërkombëtarë, median dhe qytetarët.

Më tej, në lidhje me këtë proces mjaft të rëndësishëm, KZLN thekson nevojën e reflektimit në reformën elektorale të rekomandimeve që pasuan zgjedhjet e përgjithshme 2013 dhe zgjedhjet lokale 2015 nga OSBE/ODIHR, KZLN, Dhoma Elektorale, Komiteti i Helsinkit, KVV apo nga organizatave të tjera të shoqërisë civile në lidhje me mbarëvajtjen e zgjedhjeve dhe proceseve që lidhen me to.

Në mënyrë specifike dhe jo shteruese, KZLN kërkon nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore të marrë parasysh: 1) Përfundimin e procesit të paktën një vit përpara fillimit të zgjedhjeve të ardhshme parlamentare siç e kërkojnë standardet ndërkombëtare; 2) Garantimin e qëndrueshmërisë dhe profesionalizmit të administratës zgjedhore në çdo nivel, duke parë mundësinë e një administrate zgjedhore të depolitizuar; 3) Shtimin e pjesëmarrjes së grave në



organet e administrates zgjedhore; 4) Rregullimin e financimit të fushatave elektorale; 5) Garantimin e pastërtisë së figurës së kandidatëve në zgjedhje; 6) Garantimin real të së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur për kategori të disavantazhuara të shoqërisë si personat me aftësi të kufizuara, komuniteti Rom dhe Egjiptian, emigrantët shqiptarë në botë dhe kategori të tjera të përjashtuara deri më sot; 7) Rritjen e pjesëmarrjes së grave si zgjedhëse dhe të zgjedhura duke përmirësuar cilësimet mbi kuotat gjinore apo garantimin e mekanizmave të tjerë pjesëmarrës në varësi të ndryshimeve potenciale të sistemit zgjedhor; 8) Garantimin e numërimit të ndershëm të votave dhe marrjen në konsideratë të mundësisë për numërimin e votave në qendrat e votimit, në vend të një procesi të centralizuar të cilit i mungon transparenca dhe besueshmëria.

KZLN fton palët e interesuara që përveç rekomadimeve specifike për ndryshimet në Kodin Zgjedhor, t'u referohen edhe standardeve ndërkombëtare për përpilimin e reformës zgjedhore në mënyrë që të sigurohet gjithpërfshirja dhe qëndrueshmëria në kohë e rregullave zgjedhore.

Në përfundim të kësaj deklarate, KZLN dëshiron të theksojë gadishmërinë për përfshirje në procesin e konsultimeve dhe dëgjësive publike si dhe ofrimin e asistencës dhe ekspertizës së vet në rishikimin e Kodit Zgjedhor në lidhje me administrimin zgjedhor në përgjithësi dhe integrimin gjinor në veçanti gjatë këtij procesi të rëndësishëm për një demokraci të qëndrueshme në Shqipëri.

Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e për Demokraci të Qendrueshme (KZLN) është një organizatë e pavarur, jopartiake, e krijuar me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në votime dhe sigurimin e demokracisë së qendrueshme. KZLN u kushton vëmendje të veçantë të drejtave të njeriut para ligjit, çështjeve që ndikojnë tek votuesit me aftësi të kufizuara si dhe çështjeve të barazisë gjinore. KZLN përbëhet nga 30 organizata partnere dhe nga qindra vullnetarë në të gjithë Shqipërinë që kanë punuar në mbështetje të KZLN-së që prej vitit 2013.

Për më shumë informacion, ju lutem vizitoni faqen www.kzln.org.al dhe/ose kontaktoni me e-mail: kzln@kzln.org.al

